



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 918 / Prot.
2

Tiranë, më 17/7/2017

REKOMANDIM

Nr. 30 datë 17/7/2017

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale” i ndryshuar, neneve 77-112 të Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë,

VËREJ SE:

Në zbatim të Urdhrit Nr.159, datë 14.06.2017 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, me objekt kontrolli:

- Zbatimi i Ligjit Nr.9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit të kontrolluesit SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri – Tiranë.

Grupi i kontrollit, gjatë kryerjes së veprimeve procedurale, u asistua nga përfaqësuesit e kontrolluesit, të cilët ishin njohur me Urdhrin Nr.159, datë 14.06.2017 të Komisionerit.

Kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, (SOS Kinderdorf, organizata mëmë), me NIPT: J62021005D, është subjekt juridik me aktivitet organizatë jo fitimprurëse, duke ofruar shërbimin e kujdesit me bazë familjen për fëmijët që kanë humbur kujdesin prindëror. Ky kontrollues, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, përpunon të dhëna personale për subjektet e të dhënave “punëmarrës” e “fëmijë/të rinj”.

Nga hetimi administrativ i kryer pranë këtij kontrolluesi u konstatua:

1. Nga verifikimi në regjistrin elektronik të kontrolluesve pranë Zyrës së Komisionerit, kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë e ka kryer detyrimin për njoftim, por nuk ka kryer përditësimin e tij, konkretisht: rubrika 5.1 “Të dhëna sensitive”

(përkatësia fetare), rubrika 7.1 “*Marrësi i të dhënave personale*”, rubrika 10.1 “*Masat e sigurisë dhe politikat e ruajtjes së të dhënave personale*”, alternativa e dytë.

Konstatimi i pikës 1 të këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, - “*1. Çdo kontrollues duhet të njoftojë Komisionerin për përpunimin e të dhënave personale, për të cilat është përgjegjës. Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë*”.

2. Kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, nuk ka një rregullore të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, përveç nenit 32 të Rregullores së Brendshme të tij, si dhe udhëzimit specifik mbi “*Politika për përdorimin e sistemit & aksesit*”.

Konstatimi i pikës 2 të këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, - “*1. Kontrolluesi ose përpunuesi merr masa organizative dhe teknike të përshtatshme për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar, veçanërisht kur përpunimi i të dhënave bëhet në rrjet, si dhe nga çdo formë tjetër e paligjshme përpunimi.*

2. Kontrolluesi merr këto masa të veçanta sigurie:

2/1. Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera”.

3. Kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, në formularin tip, “*Kërkesë për hyrjen e një fëmije në SOS Fshatrat e Fëmijëve*” Shqipëri - Tiranë, kapitulli I. “*Fëmija*” dhe kapitulli II. “*Nëna e Fëmijës*”, mbledh të dhëna sensitive të kategorisë “*Përkatësia fetare*”, kategori e cila në kuptim të nenit 5 germa “c” e tejkalon qëllimin e përpunimit.

Konstatimi i pikës 3 të këtij procesverballi, përbën shkelje të nenit 5 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, “*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*” i ndryshuar, - “*1. Mbrojtja e të dhënave personale bazohet:*

c) në mjaftueshmërinë e të dhënave, të cilat duhet të lidhen me qëllimin e përpunimit dhe të mos e tejkalojnë këtë qëllim”.

4. Kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, nuk ka publikuar në portalin zyrtar të tij “*Politikat e Privatësisë*”. Informacioni i publikuar në “*Politikat e Privatësisë*”, ka për qëllim informimin e subjekteve që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjes së konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Konstatimi i pikës 4 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, - "1. Kontrolluesi, kur mbledh të dhëna personale, duhet të informojë subjektin e të dhënave për fushën dhe qëllimin, për të cilin do të përpunohen të dhënat personale, për personin që do t'i përpunojë të dhënat, për mënyrën e përpunimit, përveç rastit kur subjekti i të dhënave është në dijeni të këtij informacioni. Kontrolluesi duhet të informojë subjektin e të dhënave për të drejtën për akses, si dhe të drejtën për korrigjim të të dhënave të tij.

2. Në rast se kontrolluesi përpunon të dhëna personale, të marra nga subjekti i të dhënave, ai është i detyruar të informojë subjektin e të dhënave nëse dhënia e të dhënave personale është e detyrueshme apo vullnetare. Nëse subjekti i të dhënave, në bazë të një akti ligjor ose nënligjor, është i detyruar të japë të dhëna personale për përpunim, kontrolluesi e informon edhe rreth këtij fakti, si dhe rreth pasojave të refuzimit të dhënës së të dhënave personale".

5. Kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, ka disa rregulla dhe formularë mbi konfidencialitetin, për punëmarrës dhe vizitorë, por këto formate nuk kanë standardin e Deklaratës së Konfidencialitetit sipas Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit, ku parashikohen: **Objekti, qëllimi, fusha e veprimit, masat për shpërdorimin e tyre, si dhe nënshkrimin e punëdhënësit.**

Konstatimi i pikës 5 të këtij procesverbali, përbën shkelje të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, - "Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj".

Në përfundim të procedurës së kontrollit, Zyra e Komisionerit, mban në konsideratë faktin që kontrolluesi ka qenë në bashkëpunim serioz me grupin e hetimit administrativ gjatë ushtrimit të kontrollit.

Sa më sipër:

Në zbatim të nenit 32/1 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

REKOMANDOJ:

1. Në zbatim të nenit 21 dhe 22 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, të realizojë në vazhdimësi detyrimin mbi përditësimin e Formularit të Njoftimit.
2. Në zbatim të nenit 27 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, të hartojë

dhe përshtatë në funksion të aktivitetit të tij rregulloren për "Mbrotjtjen, Përpunimin, Ruajtjen dhe Sigurinë e të Dhënave Personale".

3. Në zbatim të nenit 5 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, të rishikojë gamën e të dhënave që mbledh, duke patur parasysh, mjaftueshmërinë e tyre, si dhe mos tejkalimin e qëllimit për të cilat janë mbledhur dhe përpunohen këto të dhëna.
4. Në zbatim të nenit 18 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, të përfshijë në faqen zyrtare të tij, rubrikën "Politikat e Privatësisë".
5. Në zbatim të nenit 28 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri - Tiranë, të marrë masa për të pajisur me Deklarata Konfidencialiteti të gjithë punëmarrësit që aksesojnë të dhëna personale gjatë ushtrimit të detyrës pranë këtij kontrolluesi, sipas standardit të parashikuar në Vendimit Nr.6 datë 05.08.2013 të Komisionerit.
6. Kontrolluesi SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqipëri Tiranë, të realizojë plotësimet e detyrimeve të parashikuara në pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5 të këtij Rekomandimi, brenda afatit 60 ditor nga momenti i marrjes dijeni.
7. Në rast mos përmbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30/2 dhe 39 të Ligjit Nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrotjtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar. Komisioneri në rast shkeljesh serioze, të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vendos sanksion me gjobë për kundërvajtjet administrative dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave.

Ky Rekomandim u shpall sot më datë 17/7 2017

BËSNIK DERVISHI

KOMISIONERI